**KONTRATË SHITJE**
**TË KUOTAVE TË KAPITALIT TË SHOQËRISË**
**ITAL COFANI ALBANIA SHPK**

Sot, më datë 29.03.2021, palët e mëposhtme:

1. **Znj. Elona Haveriku,** shtetase shqiptare lindur me 17.06.1975, ne Durres, me banim ne Tirane, mbajtëse e kartes se identitetit me Nr. 028896662, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

   (Ketu e meposhte referuar bashkërisht të dy palët si "**Shitësi**")

   **DHE**

2. **Z. Erion Meçaj**, shtetas shqiptar lindur me 11.11.1987, ne Durres, me banim ne Durres, mbajtës i kartes se identitetit me Nr. 033635424, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
   (Këtu e mëposhtë referuar si "**Blerësi**")

Shitësi dhe Blerësi do të referohen bashkërisht si "**Palët**".
Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë kontratë shitje të kuotave të shoqërisë me kushtet e mëposhtme:

**DEKLARIME PARAPRAKE**
Shitësi zotëron:

**Znj. Elona Haveriku** me 33,22% te kapitalit te shoqerise që korrespondon në 1 kuote me një vlerë totale prej 335.533 (treqind tridhjete pesemije peseqind tridhjete tre) Lekë të shoqërisë **ITAL COFANI ALBANIA SHPK**, me **Nr. N.I.P.T: L71413503N**, (këtu e mëposhtë referuar si "**Shoqëria**"

**Neni 1**
**Objekti i Kontratës**

Me anë të kësaj kontrate Shitësi i transferon Blerësit me anë të **shitblerjes 33,22% te kapitalit te barabarte me 1 kuote, me nje vlere te pergjithshme 335.533 (treqind tridhjetepesemije peseqind tridhjete e tre) ALL.**

1.1 Blerësi deklaron se pranon të blejë pjesët (kuotat) e kapitalit të Shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate.

1.2 Transferimi nëpërmjet shitblerjes do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqipëtar në fuqi dhe më veçanërisht me dispozitat e Kodit Civil dhe Ligjit Nr. 9901/2008 të ndyshuar, "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*".

**Neni 2**

**Çmimi dhe mënyra e pagesës**

2.1 Transferimi i pjesëve (kuotave) të kapitalit të shoqërisë sipas përshkrimit të nenit 1.1 të kësaj kontrate nga Shitësi tek Blerësi do të kryhet përkundrejt çmimit prej 335.533 (treqind tridhjetepesemije peseqind tridhjete e tre) ALL.

2.2 Palët deklarojnë së çmimi i përcaktuar në nenin 2.1 të kësaj kontrate është paguar tërësisht nga Blerësi në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

**Neni 3**

**Kalimi i Pronësisë**

3.1 Pas nënshkrimit të kësaj kontrate Blerësi bëhet titullar i të gjitha të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me pjesen e tij ne kapital, përfshirë pjesëmarrjen në fitimet e Shoqërisë, sipas përcaktimeve në Statutin e Shoqërisë. Pas nenshkrimit te kesaj Kontrate, raportet e ortakeve ne shoqeri do te jene si me poshte:

**Z. Erion Meçaj** do te zoteroje 66,45% te kapitalit te shoqerise, e barabarte me **nje** kuote, me nje vlere te pergjithshme prej 671067 Leke; dhe

**Z. Trashgim Dervishaj** do te zoteroje 33,22% te kapitalit te shoqerise, e barabarte me nje kuote, me nje vlere te pergjithshme prej 335533 Leke; dhe

**Z. Matteo Leopardi** do te zoteroje 0,33% te kapitalit te shoqerise, e barabarte me nje kuote, me nje vlere te pergjithshme prej 3300 Leke

**Neni 4**

**Garancitë**

4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se kapitali i shoqërisë objekt të kësaj kontrate, janë të transferueshme dhe të lira nga çdo barrë, hipotekë apo çdo mjet tjetër për sigurimin e ekzekutimit të detyrimit në përputhje me Legjislacionin shqiptar në fuqi.

4.2 Shitësi deklaron se Shoqëria ka depozituar dhe paguar rregullisht dhe në kohë të gjitha tatimet, taksat, pagesa të kontributit shoqëror, kontribute të çdo lloji, zbritje apo mbajtje të çdo tipi të aplikuar në Republikën e Shqipërisë në lidhje me të ardhurat, fitimet, pasuritë neto, doganat, vlerës së shtuar apo çdo referencë tjetër, në nivel kombëtar apo lokal të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

**Neni 5**
**Forca Madhore**

5.1 Asnjëra nga Palët nuk do të konsiderohet përgjegjëse në rast se plotësimi i çfardolloj dispozite vendosur në këtë Kontratë do të vonohet ose do të ndalohet për shkak të forcave madhore ose rastit fator dhe në mënyrë të vecantë për shkaqet si, revolucione, çrregullime, lëvizje popullore, luftra, greva, zjarre, përmbytje, tërmete, fenomene të natyrës, shtetëzime, shpronësime, ose akte të pushtetit qëndror apo lokal që kufizojnë lirinë personale apo të sipërmarrjes.

**Neni 6**
**Interpretimi i Kontratës në tërësi**

6.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e terësise së Kontratës dhe brenda qëllimit që i bëri Palët të nënshkruajnë këtë Kontratë.

**Neni 7**
**Legjislacioni i zbatueshem**

7.1 Për sa i përket çështjeve që kjo Kontratë nuk i rregullon shprehimisht, ato do të rregullohen nga dispozitat e neneve të Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë si dhe ligje, dispozita e norma të tjera që janë në fuqi, të cilat drejtëpërdrejtë apo tërthorazi lidhen me objektin e kësaj kontrate.

**Neni 8**
**Zgjidhja e mosmarreveshjeve**

8.1 Palët bien dakort që çdo mosmarreveshje që mund të lindë nga interpretimi dhe/ose zbatimi i kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim nëpërmjet bisedimeve mes Palëve. Në rast se

bisedimet nuk do të japin rezultat, atëherë konflikti do të zgjidhet nga Gjykata e Shkalles se Pare Durres Shqipëri.

**Neni 9**
**Shpenzimet**

9.1 Shpenzimet për regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit do të jenë në ngarkim të Palëve.

**Neni 10**
**Ndryshimet**

10.1 Çdo ndryshim i përmbajtjes së kësaj Kontrate, duhet të bëhet me shkrim dhe do të firmoset nga Palët.

**Neni 11**
**Hyrja ne fuqi**

11.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.

**Neni 12**
**Gjuha e kontratës**

12.1 Kontrata perpilohet në 4 kopje të njëjta në gjuhën Shqipe.

*****

**PALËT**

| | |
|---|---|
| **SHITËSIT** | **BLERËSI** |
| **Znj. Elona Haveriku** | **Z. Erion Meçaj** |
| Elona Haveriku | |